



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 02.02.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë, Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë, Anton Quni, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Deputetët e Kuvendi të Kosovës, pjesëmarrës në takim- Mytaher Haskuka-Lëvizja VV dhe Valdete Bajrami- Partia NISMA.

Pjesëmarrësit nga Ministria e Punëve të Brendshme- Skender Hyseni-Ministër i MPB-së, Shqipe Mjekiqi-Këshilltare e ministrit, Shkodran Manaj-Këshilltar i ministrit, Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Skender Perteshi-QKSS, Ardiana Gashi-OSBE, Lumnije Murati-Zyra e presidentes së Kosovës dhe Krenare Loxhaj-QKSS, Vlora Nushi- UNMIK-OPA, Luanda Domi-DCAF.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 26.01.2015;

3. Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni;
4. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 26.01.2015

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 26.01.2015.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni.

Kryetari- I uroi mirëseardhje në Komision dhe theksoi se me kërkesë të anëtarëve të Komisionit është ftuar për të raportuar bashkë me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Si Komision janë të brengosur për situatën e fundit, por anëtarët e Komisionit kanë kërkuar shpjegim për dy çështje: arrestimin e një qytetari serb me eksplozivë në Prishtinë dhe për eskalimin e dhunës me rastin e protestave dhe për çështjen nëse është marrë leje nga Lëvizja Vetëvendosje. Fjalën ia dha ministrit z. Skender Hyseni.

Ministri i Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni- Falënderoi Komisionin për ftesën dhe konsideroi të domosdoshme që sipas nevojës të diskutohet për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë në vend. Gjithashtu theksoi se do të jetë në dispozicion për të trajtuar çështje, sa herë që të jetë e nevojshme dhe se do të jetë i hapur për pyetje.

Sa i përket rastit Gavriq, është rasti kur Policia e Kosovës dhe njësitë e tjera kanë demonstruar vigjilencë dhe profesionalizëm të theksuar. Policia e Kosovës pas informatave të shumta që ka marrë nga qarqe të ndryshme, informata të klasifikuara ka ndodhur arrestimi i qytetarit serb me shtetësi serbe dhe banues në Serbi. Ky arrestim ka ndodhur në lagjen Arbëria në Prishtinë me 12.19 kg materie eksplozive.

Nga ana e Policisë së Kosovës është konsideruar dështim nga ana e policisë kufitare në Jarinjë, mes Kosovës dhe Serbisë. Për këtë arsye katër oficerë policorë janë të suspenduar dhe ndaj tyre zhvillohen hetime nëse nuk kanë dëshmuar vigjilencë dhe profesionalizëm në detyrë. Por Policia e Kosovës me njësitet përkatëse në aksionin vendosur, qytetari serb i cili është nën hetime dhe të

cilit i është vazhduar paraburgimi edhe për gjashtëdhjetë ditë të tjera, është arrestuar nën dyshimin eksplisit se materia eksplozive që barte, do të mund të përdorej për akt terrorist. I dyshuari është duke u hetuar dhe është në duart e Prokurorisë.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe PK, në prononcimet publike do të udhëhiqet nga faktet në dispozicion dhe jo nga perceptimit, gjithashtu edhe nga nevoja e ruajtjes së integritetit të procesit hetimor, në mënyrë që nga ky rast të marrim mësim dhe të përgatitemi për raste të ngjashme.

Me këtë pikë përfundojë këtu, pasi konsiderojmë që kaq mund të thuhet për momentin, dhe me lejen tuaj do të kaloj në pyetjen tjetër e cila është bërë nga ana juaj për protestat e ditëve të kaluara. Theksoi se ka qenë pjesë e procesit të hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se e drejta për të protestuar është përfshirë në këtë Kushtetutë dhe njihet si e drejtë e pa tjetërsueshme dhe secili qytetar apo grupim politik, organizate e kanë të drejtën për të protestuar, të thërras protestë dhe të organizoj protestë.

Sipas njoftimit që më është dhënë nga Policia e Kosovës, organizatori nuk e ka lajmëruar protestën te Policia, protesta është lajmëruar në media, por jo në Policinë e Kosovës, siç e parasheh ligji. Policia e Kosovës dhe njësitet përkatëse kanë bërë përgatitjet e duhura që protestën ta sigurojnë, në mënyrë që të krijohet ambient i përshtatshëm për të protestuar.

Ka pasur interpretime nëse duhet marrë leje apo vetëm duhet njoftuar, por bazuar në ligjin për tubime publike, theksohet se për të protestuar në vende të caktuara kërkohet edhe leje dhe mund të protestohet vetëm pasi është marrë leje, para objekteve të rëndësisë së veçantë.

Siguron Komisionin dhe gjithë qytetarët e Kosovës se te Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ekziston qëllimi më i vogël për të politizuar apo për të ngulfatur të drejtën e protestës. Është absurde që të dëgjohet se ekziston qëllimi për të ndaluar të drejtën për të protestuar, janë paralajmëruar protesta në ditët në vijim dhe për këtë siguroj qytetarët që policia e Kosovës dhe institucionet e ligjit do të sigurojnë ambient të qetë për të protestuar.

Protesta në stilin me ultimatum, që “policia të tërhiqet për pesëmbëdhjetë minuta” nuk ka në asnjë vend demokratik dhe polici që guxon të pranojë ultimatum të tillë, pasi në këto raste dështon shteti. Leje nga policia për të protestuar në vende të caktuara nuk kërkohet, është obligim i organizatorëve që të njoftojë dhe të lajmërojë policinë për vendin e protestës, në mënyrë që të sigurohet ambient i qetë për protestën dhe sipas raportit që më është dhënë nuk ka ndodhur një lajmërim i tillë.

Kryetari- Kërkesa për të shtruar pyetjen nëse është marrë leje nga ana e protestuesve apo jo, është bërë nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe jo nga ana ime.

Zafir Berisha- Për kërkesën e cila është referuar rreth çështjes së arrestimit për rastin Gavriq dhe më pas protestat.

Konsideroi se arrestimi i qytetarit serb me eksploziv ka qenë gjë e mirë, por forma se si është prezantuar ka qenë e ekzagjeruar. Pasi nga paraqitja e parë nga ministri dukej sikur ky eksplozivë do të përfshinte rajone të mëdha dhe më pas nga mediat doli që ka qenë i paketuar.

Duke krahasuar me disa raste të tjera të arrestimeve sikur po dëmtojmë imazhin e Kosovës, siç ka qenë rasti i arrestimeve në verën e kaluar për terrorizëm i disa klerikëve fetar. Për këtë arsye konsideroj se kjo politikë ndikon në prishjen e imazhit dhe jo në luftimin e terrorizmit ose krimin të organizuar.

Ndërsa sa i përket protestave shtoi se në rastin e protestave policia nuk ka qenë në krye të detyrës, pasi dëmtimi i pronës nga një numër i vogël të protestuesve dhe mos ndërhyrja e policisë konsideroi se ka qenë me qëllim për të prishur imazhin paqësor të protestës, pasi kanë qenë

numër i vogël që kanë bërë veprim të tillë. Ndërsa as i përket protestës së dytë, nuk kanë qenë protestuesit të parët që kanë provokuar, pra Policia ka ndërhyrë nga frika se mos po përdorët dhunë.

Pastaj theksoi se pasi ministri është hartues i Kushtetutës, neni 94.2 të Kushtetutës, thuhet se ministri përfaqëson politikën e Qeverisë, dhe nëse z. Jabllanoviq përfaqëson politikën e Qeverisë. Konsideroi se protestuesit kanë qenë të arsyeshëm pasi është sulmuar një segment i cili ka mbrojtur politikën fashiste të një ministri, që qytetarët i ka quajtur egërsira, ndërkohë që financohet nga taksat e këtyre qytetarëve.

Prandaj konsideroj se protestat ka qenë e arsyeshme dhe se nuk pajtohet me dhunën, ndërsa sa i përket nëse protesta është politike, konsideroi se gjithkund protesta është puro politike. Përdorim i forcës ka qenë i tepruar, është gjuajtur me armë, për këtë arsye, arrestimi i kryetarit të Komunës pa arsye.

Konsideroi se zinxhiri komandues për menaxhimin e situatës ka dështuar, pasi nga prizmi im nuk do të duhej të lihejshin njëzet policë përpara protestuesve të arsyeshëm. Të gjitha këto do të duhej një përgjigje dhe për këtë konsideroj se nga ju z. ministër duhet të merrni masa në zinxhirin komandues, pasi skenat e para e kanë dëmtuar imazhin Kosovës.

Ministri Skender Hyseni- Mendoj që mediat duhet të jenë këtu, pasi janë çështje për të cilat duhet të njihet opinioni me qëllim për t'i kontribuar ambientit demokratik. Nuk e theksova që e drejta për protestë mohohet, përkundrazi e drejta për protestë e partive politike është e drejtë e pa mohuar. Prandaj nuk do doja të më adresohet diçka që nuk e kam thënë z. Berisha, është çështje e organizatorit çka përcakton si motiv për protestë, pasi sot këtu jemi për rregullën e protestës. Ndërsa sa i përket asaj nëse ka pasur ose jo tejkalim të dhunës gjatë kësaj proteste do të flas drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Institucionet përkatëse brenda policisë si dhe IPK duhet të hetojnë çdo situatë që mund të paraqitet nga dikush si tejkalim.

Anton Quni- Në lidhje me rastin e arrestimit të qytetarit serb Gavriq, për bartje të eksplozivit, nga njohurit që i posedoj, është e ditur që vetëm eksplozivi nuk mjafton për ta vënë në funksion, janë edhe mjetet e tjera shtesë për ta aktivizuar, mënyrë e aktivizimit.

Pasi ky rast u ngrit në nivelin e spekulimit dhe ne sipas imagjinatave të vijnë në përfundimin se cila ka qenë arsye e eksplodimit të eksplozivit, a ka qenë ky person përgjegjës për eksplodimin tij, a i kishte mjetet shtesë, mënyrat e kontrollit?

Apo ka qenë një transportues, tregtar apo person i cili nuk ka njohuri për përdorimin e kësaj mase të rrezikshme?

Konsideroj se nga ana e juaj janë nxjerrë këto informata pasi kjo çështje është e ndjeshme, varet nga ju sa do të deklaroni dhe sa është për opinion.

Ndërsa lidhur me protestat, është fakt që gjatë protestës është ushtruar dhunë nga protestuesit, është përdorur dhuna nga autoritetet e policisë për të mbajtur nën kontroll protestën, por të gjithë kemi qenë viktimë duke shikuar këtë pamje.

Sa keni arritur të identifikoni z. drejtor i Policisë grupet që kanë marrë pjesë në protestë me maska, cilit formacion politik i përkasin, kush i ka përgatitur, kujt i japin llogari?

Gjithashtu gjatë protestës janë përdorur mjete të forta, pse ky fenomen, pse kjo urrejtje ndaj uniformave, formacioni i kujt është, nga kush janë motivuar?

Gjithashtu është përdorur një mjet shumë i rrezikshëm, Koktej Molotovi, ku efekti i saj është të rrezikoj jetën e zyrtarëve të policisë. A keni arritur të identifikohen këta persona, të cilët duken moshë e re, çka është e përbashkëta dhe qëllimi i tyre? Sa mundeni që ju të punoni dhe ne si shoqëri dhe gjitha institucionet, që këtë grup me ose pa vetëdijen e tyre, t'i edukojmë, dhe të bëjmë me dije që atë ditë kanë qenë në shërbim të skenarëve të atyre që kombit tonë ia dojnë të keqen.

Përkundër vlerësimeve të mira që kam për njësit e Policisë së Kosovës, edhe brenda njërive kemi qenë dëshmitarë kur ka pasur raste që kalojnë autorizimet e veta, në rastin kur e kanë nën kontroll një protestues ushtrojnë dhunë.

Sa di të arrini që këta zyrtarë t'i disiplinojnë, të sjellën para përgjegjësisë, që në protestën e radhës të mos përsëritën.

Gjithashtu në takimet e ardhshme do të ishte mirë të kemi kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës dhe zyrtarët në kuadër të PK-së të cilët ushtrojnë kontrollin e brendshëm në kuadër të policisë, për të parë se cilat janë masat që do të ndërmerrini në mënyrë që mos të ndodhin dukuri të tilla dhe cilat janë masat që ndërmerrni kur identifikohen raste të tilla?

Më tutje bëri pyetje për drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Marr në konsideratë që nuk kemi përvojë në kontrollin e turmave, analizat e juaja pas veprimit, cilat mësimë janë nxjerrë, performanca e kuadrove, përvojave teknikat e përdorura etj., mënyra e veprimit dhe a janë të duhurat?

Nuredin Ibishi- Lidhur me rastin Gavriq, i cili ka qenë një shqetësim për të gjithë opinionin për sasinë e eksplozivit që ka bartur edhe pse është çështje nën hetime, tha se do të sugjeroja që Ligji për Policinë e Kosovës të zbatohet, përkatësisht neni 22, që i referohet kontrollit parandalues.

Pasi është ligjore që nga ana e policisë të shtohet kontrolli dhe të bëjë kontrollin, por në raste të tilla Policia lajmëron Prokurorinë dhe prokuroria vendos nëse ai kontroll është i arsyeshëm apo jo. Sugjeroi që në të ardhmen të shtohet një kontroll i brendshëm.

Ndërsa sa i përket protestave, nisur nga baza legale e paralajmërimit të protestave konsideroi se është në ligj dhe është detyrë e qytetarëve dhe deputetëve të respektojnë ligjin.

Në përfundim të fjalës së tij shtoi se Ligji duhet të zbatohet dhe në rastet kur protestuesit nuk njoftojnë për tubim publik, policia merr masat sipas vlerësimit të tyre, pasi secila palë ka obligimet dhe detyrat e tyre.

Ganimete Musliu- Theksoi se ka shuar pyetje për ministrin dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, por që në këtë takim do të fokusohet në çështjet për të cilat janë ftuar të raportojnë.

Sa i përket rastit Gavriq, konsideroj se nuk është bërë çështje e zmadhuar, pasi nëse do të kishte ndodhur në shtetin nga vjen qytetari i cili ka bartur eksploziv, do të thirrej mbledhje në Këshillin Sigurimit.

Përgëzoi Policinë e Kosovës për punën efikase që kanë bërë, gjithashtu shtoi se pak ka rëndësi sasia e eksplozivit që është zënë, por më me rëndësi është motivi dhe synimi me atë akt, prandaj përgëzoj policinë për këtë sukses dhe për masat e marra për zyrtarët policorë të cilët kanë qenë në pikën kufitare në Jarinjë.

Lidhur me protestën e zhvilluar, shtoi pyetjet si vijon.

Cila është gjendja shëndetësore e policëve të lënduar në protestë? Cilat janë masat që ka ndërmarrë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës që t'u dalin në ndihmë policëve që ata të shërohen dhe t'i kthehen detyrës zyrtare?

A do të lejohet që në protesta e radhës të parapara të mbahen më 4 shkurt, skena terrorizuese të ndodhin në Prishtinë? A është e gatshme Policia që mos të ndodhin pamje të tilla?

Fadil Demaku- Përshëndeti të pranishëm dhe theksoi që nuk do të bëjë pyetje konkrete, por shqetësimi i tij si deputet dhe anëtar i Komisionit është që nuk duhet të lejojmë që situata të dalë jashtë kontrollit, duke ia bartur fajin njëres palë apo tjetres.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se të gjithë ata që janë pjesë e institucioneve të vendit duhet të veprojnë sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, pasi janë përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Gjithashtu konsideroi se të gjitha palët e përfshira në zhvillimet e fundit duhet të jenë të përgjegjshëm për atë që ndodhi, pasi veprimet momentale janë të pa menduara dhe pasojat janë më të mëdha.

Më tutje vlerësoi se nuk guxojmë të biem pre e politikave të caktuara që mund të jenë të përgatitura nga qarqet armiqësore të vendit tonë.

Ndërsa sa përket rastit të ministrit Jabllanoviq, theksoi se si deputet përkrah qëndrimin se ky ministër nuk do duhej të ishte më pjesë e Qeverisë, pas asaj që ka thënë. Por si vend duhet të fokusohemi në ruajtjen e rendit dhe sigurisë dhe të parandalojmë veprimet që janë rrezik për vendin tonë, pasi kjo nuk i shërben imazhit të shtetit.

Bojan Mitiq- Përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se sa i përket rastit Gavriq, si përfaqësues i Listës Serbe, dëshiron që ky rast të zbardhet dhe që Policia e Kosovës të kryej punën në mënyrë të ndershme në mënyrë që të kemi informata të sakta. Konsideroj se Policia e Kosovës ka kryer punën e vet për të cilën është ngarkuar.

Ndërsa sa i përket protestave të cilat janë planifikuar për datën 4 shkurt, ekziston shqetësimi që të mos përsëritet marsi i 2004, ku edhe vetë ka qenë viktimë e dhunës, pasi kjo situatë nuk do të ishte e mirë as për qytetarët dhe imazhin e Kosovës.

Pyeti: A është policia e gatshme të pengojë dhunën në përmasa të mëdha?

Sa është numri i policëve që do të sigurojnë protestën?

Qerim Bajrami- Përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se ka pasur disa pyetje. Kësaj here nuk do t'i parashtrojë, por do të fokusohet në çështjet për të cilat është kërkuar që të raportojnë ministrit dhe drejtorit të Policisë.

Sa i përket rasit Gavriq shpresoj që policia do të vazhdojë hetimin dhe të zbardhë rastin sipas ligjit. Ndërsa sa i përket protestave, konsideroi se Policia e Kosovës është e të gjithë qytetarëve, ndërsa skenat që janë parë në Prishtinë nuk janë pritur nga qytetarët e Kosovës dhe kjo gjë nuk është pritur as nga komunitet që jetojnë në Kosovë.

Nëse ka kuptim do të apeloja para opinionit që çdo kush ka të drejtë të protestojë, por askush nuk ka të drejtë të kalojë kornizat ligjore dhe se edhe Policia duhet të trajtojë në mënyrë adekuate, ndërsa në rastet kur është tejkaluar forca janë organet adekuate që do të trajtojnë këto raste. Prandaj konsideroj se askush, pavarësisht pozitës që ka, nuk meriton plagë nga ajo protestë dhe gjithkush dihet të mendojë për pronën e vet dhe ne si persona publikë kemi përgjegjësinë për atë që deklarojmë.

Kryetari- Theksoi se në mungesë të deputetit nga VV në Komision, fjalën ia kaloi deputetit Mytaher Haskuka nga Lëvizja Vetëvendosje, i cili është pjesë e këtij takimi.

Mytaher Haskuka- anëtar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, barazi Gjinore dhe Peticione- Lidhur me protestën e zhvilluar në Prishtinë shtroi pyetjet si vijon për ministrin. Pse janë bllokuar rrugët për Prishtinë. Pse janë kontrolluar autobusët? Pse janë nxjerrë jashtë nga autobusët?

Theksuat se nuk ka pasur paralajmërim, në media është folur për protestën dhe është ditë ora dhe vendi i protestës. Nëse konsideroni se nuk është ditur për protestën, atëherë pse gjysma e sheshit ka qenë e bllokuar? Nëse protesta është e drejtë bazike dhe e shenjtë sipas jush, pse është hequr bina për folësit? Pse kur janë larguar protestuesit nga sheshi është vazhduar të hidhet gazi lotsjellës? Pse është përdorur gazi lotsjellës ndaj rendit të parë të protestuesve të cilët kanë qenë të angazhuar të mbajnë rendin? Edhe ndaj deputetëve dhe kryetarit të Komunës është hedhur gazi lotsjellës, a është bërë kjo me qëllim? A ka pasur edhe policë të njëjstëve të tjera që janë dërguar për të shpërndarë protestën? Gjithashtu është vërejtur që ka pasur policë pa mjete mbrojtëse të cilët kanë qenë në protestë, kjo i shkel edhe të drejtat e policëve pasi pa mjete mbrojtëse kanë dalë në protestë.

Ka pasur skena të rrahjeve të atyre që janë arrestuar, dhe kjo sipas ligjin kur arrestohet dhe nuk bënë rezistencë nuk ushtrohet dhunë ndaj tyre. Gjithashtu ka pasur raste kur janë arrestuar qytetarë vetëm se kanë qenë në shesh, pa ndonjë arsye. Pyetja është se a do të ndërmerren masa ndaj këtyre policëve që i kanë tejkaluar masat në kryerje e detyrës zyrtare?

Kryetari- Konsideroi se dhunën nuk e pëlqen askush, pasi skena të tilla e dëmtojnë qytetarin e Kosovës dhe pasurinë publike. Ndërsa nëse ky tubim është i lajmëruar, por jo, konsideroj se sheshi i takon popullit të Kosovës, për kërkimin e lejes janë disa pozicione dhe për të jemi në dijeni.

Pakënaqësia ka rrjedhur për shkak të një vendimi për Trepçën, të cilin e kemi konsideruar të padrejtë dhe të një ministri i cili ka fyer qytetarët dhe për të cilin Kryeministri nuk ka guxim ta shkarkojë. Ne kemi parë skena kur kemi humb qytetarë në veri, policë të forcave speciale, rastin kur qytetari serb me eksploziv serb ka kaluar kufirin, dhe nuk është rritur kontrolli kufitar. Gjithashtu ka dyshime që brenda protestuesve ka pasur individë të caktuar të infiltruar për të cilën gjë nuk kamë fakte, sidoqoftë përdorimi i forcës policore ndaj qytetarëve të Kosovës në mënyrë jo racionale është i pa pranueshëm.

Prandaj në protestën e kaluar konsideroi se polici a ka tejkaluar përgjegjësinë e vet, duke përdorur sprej, tortura dhe masa fizike, të plagosur me plumba gome.

Prandaj e shtroj pyetjen: Kush ka dhënë urdhrin për të gjuajtur me plumba gome mbi qytetarët, e ka dhënë ministri, drejtori i Policisë apo kush? Pse kur është arrestuar kryetari i Komunës së Prishtinës, i është thënë "kemi urdher për të arrestuar" dhe më pas i njëjti është liruar? Ndërsa qytetarë të tjerë të arrestuar të njëjtën kohë janë mbajtur. A është ligji i barabartë për të gjithë?

Pra konsideroj se skena të tilla nuk i pëlqejnë askujt, ndoshta ka pasur tejkalim të dhunës nga ana e qytetarëve, por policia duhet të jetë e përgatitur për menaxhimin e situatave të tilla.

Nga ana e Komisionit do të keni përkrahjen tonë që të jeni në krye të detyrës dhe fjalën ia dha ministrit, Skender Hyseni.

Ministri Skender Hyseni- Në përgjigjeje të pyetjes së kryetarit të Komisionit, tha se shpreh habi dhe mospajtim me konstatimin nëse ka ndodhur ashtu apo jo. Konsideroj se ka ndodhur dhunë e pa pranueshme, ndërsa si ka ndodhur dhe pse, do ta japin fjalën organet përkatëse të Policisë së Kosovës. Ai thekson se ka një numër të madhe të qytetarëve dhe policëve të lënduar, dhe nuk është ndjenjë e mirë kur dihet që lëndimet janë më të mëdha te policët se te qytetarët. Më bën të ndihem mirë fakti që nuk ka qytetarë të lënduar rëndë, siç ka policë të lënduar rëndë, ku njëri nga zyrtarët policorë është dërguar për trajtim jashtë vendit.

Nuk do të analizoj se si ka ndodhur, pasi janë organet përkatëse që japin vlerësimin. Ndërsa sa i përket pyetjes se ministri ka dhënë urdhra të kësaj apo asaj natyre, jo me rastin e kësaj proteste, por ju garantoj ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës se, më parë do të kërkoja azil në Siberi se sa të jepja urdhra politikë Policisë së Kosovës dhe nuk do ta ngatërroja politikën me detyrat që i kemi.

Pyetjes se a ka qenë racionale përdorimi i dhunës nga ana e Policisë, vlerësimet që janë duke u zhvilluar do ta japin një përgjigjeje. Do të ftoja secilin qytetar të Kosovës dhe atyre që janë në institucione dhe në Qeveri, të peshojnë fjalën publike, pasi fjala e secilit prej tyre merr konotacione të caktuara te qytetarët.

Nuk marr vesh shumë nga Koktej Molotivi, por e di që shkaktojnë dëme të mëdha, dhe për këtë mund të flas drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Ndërsa në përgjigjen të pyetjes së znj. Ganimete Musliu, tha se është një zyrtar policor i cili është dërguar për trajtim jashtë vendit, dhe janë dy policë të tjerë të lënduar rëndë, një në Prizren dhe një tjetër që i është këputur muskuli i këmbës. Kam vizituar këta policë për të parë gjendjen e tyre.

Në përgjigjeje të pyetjeve të deputetit Mytaher Haskuka, tha se drejta për protestë është e drejtë e shenjtë e përcaktuar në Kushtetutë, ndërsa ju thatë që është lajmëruar protesta në media. Neni 6 i Ligjit për tubime publike, ku i referohet lajmërimit të tubimit, kërkon që të lajmërohen 72 orë para protestës, dhe kjo gjë nuk ka ndodhur, ndërsa Policia e Kosovës duhet që më së voni 48 orë para mbajtjes së tubimit publik, të lajmërojë organizatorin për lejimin ose ndalimin e tubimit publik dhe për këtë çështje ka pasur debat edhe në media nëse ministria ka gabuar për leje apo për lajmërim.

Nëse në afatin paraparë nuk shpallet vendimi i ndalimit, atëherë tubimi konsiderohet i lejuar. Për vendin dhe kohën e mbajtjes së tubimit vendos organizatori, ndërsa tubimet publike brenda hapësirës së një institucioni nuk janë të lejuara. Pra është qartë e përcaktuar me ligj, që policia në situata të caktuara, mund ta mohojë ose mos të jap leje.

Ju thatë që ne nuk e kemi ditur që do të ketë protestë, nuk është e vërtetë pasi Policia e Kosovës edhe pse nuk është lajmëruar zyrtarisht, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për t'u përgatitur. Këtu sot nuk jam që të flasim për motivet e protestës, dhe nuk më lejohet të flas për këto motive.

Më tutje theksoi që ajo për të cilën është këtu dhe kërkon përkrahjen nga Komisioni është që duhet të funksionojë ligji dhe të zbatohet, pasi policia e Kosovës është e qytetarëve të Kosovës. Ndërsa lidhur me pyetjen se a ka pasur lëshime dhe defekte kjo duhet të analizohet.

Kryetari- Çfarë mendimi keni ju z. ministër, a ka pasur tejkalim të kompetencave, a janë të ligjshme torturat ndaj qytetarëve në lokale private? Sa qytetarë janë të penalizuar dhe sa policë, dhe a janë marrë masa ndaj tyre për tejkalim të kompetencave?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë- z. Shpend Maxhuni- Për vlerësimin e situatës së fundit tha se do të duhej më shumë kohë për ta vlerësuar. Në përgjigjeje të pyetjes së z. Zafir Berisha, se pse protesta e parë ishte paqësore, ndërsa e dyta kulmojë në të dhunshme them se si Polici e Kosovës që kur ka marrë përgjegjësinë për kryerjen e përgjegjësve ligjore që ka, prioritet i ka dhënë qasjes gjithëpërfshirëse për menaxhimin e protestave.

Policia e Kosovës ka bërë një rrugëtim të vështirë për krijimin modeleve për t' ju përshtatur rrethanave të vendit. Në fillimet e saj nga njësia speciale është aplikuar modeli i cili nuk është treguar i përshtatshëm për vendin tonë, duke falënderuar policinë tonë në bazë të vlerësimeve është zgjedhur modeli i menaxhimit të turmave.

Pyetjes se pse ka ndodhur eskalimi i situatës, është se ka qenë një masë e madhe e grumbulluar në afërsi të Qeverisë dhe ka qenë vlerësimi taktik i atyre që kanë udhëheqë me njësitë e policisë që kanë vlerësuar që në rrethanën e caktuar të datës 27 shkurt. Veprimet e dhunshme kanë ndodhur që nga mbajtja e fjalimeve të para dhe në fund ka pasur veprimi i policisë për të ndal dhunë e atyre protestuesve që kanë mbetur.

Sa i përket protestës së dytë, a ka policë të cilët janë në procedurë për tejkalim të detyrës zyrtare. Ju njoftoj që po, dhe pas vlerësimit që i është bërë ka, dhe njësia profesionale merret me analizën operacionale dhe kurdo herë që kjo analizë nxjerr se ka pasur tejkalim të kompetencave, ne mund të marrim masa.

Gjithashtu njoftoi se në këtë fazë është i angazhuar edhe Inspektorati Policor i cili është duke bashkëpunuar ngushtë me këtë njësi, dhe në bazë të konstatimit që do të bëjnë do të nxirret raporti përfundimtar për zyrtarët policorë që mund të kenë tejkaluar kompetencën në përdorimin e forcës.

Dëshiroj të theksoj që secili pjesëtar i policisë që është përballë me protestën, potencialisht ka mundur të jetë jo në mesin tonë. Veprimi i dhunshëm kërkon një analizë më të thellë për të analizuar motivet dhe shkakun e veprimeve të dhunshme dhe për këtë jemi duke punuar, ndërsa protestuesit e arrestuar do të trajtohen sipas ligjit dhe për këtë jemi në bashkëpunim me prokurorinë, ndërsa është Gjykata ajo që nxjerr vendim përfundimtar për përgjegjësinë e tyre.

Përkundër dhunës së përdorur nga protestuesit, policia ka ruajtur gjakftohtësinë nga sjelljet e protestuesve, siç ka qenë shtyrja hedhja e Koktej Molotovit, gurët etj.

Veprimi nga ana e policisë bëhet në mënyrë të planifikuar, ku jepen qartë detyrat dhe veprimet të përfshira në kuadër të planit operues. Në ditët e para kur është bërë publike nga mediat që do të ketë protestë, policia ka njoftuar që do të ketë planin operues me objektiva strategjike. Kjo është një qasje standarde, ku policia njofton opinionin për angazhimet që do të kenë, pasi u theksua këtu që pse janë penguar qytetarët.

Deri sa ne sigurohemi me veprime të planifikuara, në anën tjetër ne kufizojmë lirinë e qytetarëve të tjerë, pasi qëllimi është të mbështesim protestën me veprime ligjore. Pasi ka pasur ankesa për dëmet që janë shkaktuar gjatë protestës.

Sa i përket çështje së parashtruara nga z. Quni, që shoqëria të luaj rol të rëndësishëm, konsideroi që kontributi i gjithsecilit nga ne duhet të jetë në këtë drejtim, pasi në demokraci respektohen rregullat. Në këtë protestë duhet t'u jepen përparësi moshave të reja që janë përfshirë në protestë, prandaj Policia e Kosovës është e hapur për çdo aktivitet për të dhënë kontributin e saj duke ndikuar në aspektin pozitiv për të edukuar shoqërinë tonë.

Ndërsa sa i përket pyetjes së z. Ibishi, lidhur me kontrollin parandalues, theksoi se policia sa herë që e vlerëson që duhet aplikuar veprim që e ka bazën në këtë nen e bën, me qëllim të parandalimit të akteve të dëmshme në rrethana të ndryshme.

Sa i përket shëndetit të policëve, tha se është një numër i madh që janë të lënduar nga mjetet e forta të hedhura nga protestuesit, një zyrtar policor është dërguar jashtë vendit për trajtim, ndërsa dhe dy të tjerë janë të lënduar rëndë, njëri ka tronditje në tru, ndërsa tjetri dëmtime në këmbë.

Sa i përket pyetjes së z. Mitiq, nëse policia ka kapacitete e duhura për të menaxhuar protestën e ardhshme, them se po, ka kapacitetet, ndërsa sa i përket aspektit të organizimit, kam kërkuar një takim me subjektin politik Lëvizjen Vetëvendosja, për të analizuar planifikimet për protestën e ardhshme, por me keqardhje e them që nuk kemi gjetur mirëkuptimin në të kaluarën, por të synojmë të realizojmë këtë takim.

Siguroi që policia ka në dispozicion të gjitha kapacitete e nevojshme për t'u ballafaquar që është e mandatuara nga ligji, dhe çdo informacion që do të vijë te policia do të na shërbejë për planifikimet e nevojshme. Rugët nuk kanë qenë të bllokuara, ashtu siç mund të kuptohen nga individ të caktuar, pasi të vetmet rrugë kanë qenë ato të kryeqytetit, aty ku masa ka lëvizë dhe masa është zhvendosur, pasi është dashur të mendojë për rrjedhën normale të aktiviteteve të tjera, por duke mos penguar jetën e qytetarëve.

Veprimet taktike të policisë të cilët kanë qenë të angazhuara në këtë operacion, vlerësoi se kanë qenë konform zhvillimit të ngjarjes dhe përshkallëzimit të situatës. Pasi është veprim i Policisë së Kosovës në menaxhimin e turmave, që pas vlerësimit fillestar të ndërmerret veprimi deskalues, pasi masa ka qenë shumë e dhunshme. Prandaj policia është dashur që krahas lëvizje së protestuesve të avancojë që ta fusë situatën nën kontroll, pasi janë shpërndarë në pjesë të ndryshme.

Pyetjes se pse është përdorur gazi lotsjellës, plumbat e gomës dhe sprej dhe arma e zjarrit, them se të gjitha këto janë mjete që parashihen nga ligji për policinë për t'u përdorur sipas vlerësimeve dhe rrethanave në çfarëdo shtate. Nëse me kujdes e vlerësojmë se si ka filluar masa të veprimit kundër policisë, shihet se fillimisht ka qenë komunikimi verbal i komandantit taktik që protestuesit të qetësohen dhe të qëndrojnë në perimetrin e caktuar. Veprimi dytë ka qenë duarthatë duke komunikuar me protestuesit, por përshkallëzimi i situatës ka imponuar veprimin dhe përdorimin e spreit OC, dhe çdo policë është i certifikuar të përdor sipas autorizimit. Më pas veprimet e dhunshme kanë vazhduar ku policia është dashur të bëjë hedhjen e gazit lotsjellës dhe ka tentuar të minimizojë përdorimin tij.

Ka qenë vullneti pozitiv i policisë të durojnë për atë që sa kanë mundësi dhunën e ushtruar mbi ta, në rrethana të caktuara janë plotësuar kushtet kur polici është dashur të mbrohet në vijën ekstreme, ndërsa përdorimi i armës së zjarrit ka qenë një veprim taktik, dhe ka pasur qëllim të parandalojë vdekjen e një zyrtari policor, dhe për këtë kemi fakte dhe do të deponohen në institucionet përkatës.

Tani jemi në analizë të veprimeve që ka ndërmarrë policia dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera, siç është Inspektorati Policor, prokuroria do të dalim me vlerësimin përfundimtar dhe opinionin do të njoftohet.

Ju siguroj si Komision që Policia e Kosovës do të vazhdojë edhe në të ardhmen të përmbush obligimet dhe mandatin ligjor që ka, duke ju dhënë përparësi të drejtave të qytetarëve, por në asnjë rrethanë nuk duhet të keqkuptuar kur në bazë të vlerësimeve policia merr veprime, ato duhet të ndodhin. Edhe për protestën e parë më 4 shkurt, policia do të ketë planin operacional dhe shpresojmë që të kemi komunikim të mirëfilltë me organizatorin duke shpresuar që të kemi protestë të qetë dhe të mos ketë nevojë angazhim të policisë.

Kryetari- falënderoi ministrin dhe drejtorin Përgjithshëm të Policisë për këtë raportim, Gjithashtu theksoi se si deputet do të jemi në përkrahjen e policisë.

Ministri- Ritheksoi gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për t'u takuar kurdo që shihet e nevojshme dhe siguroi që ministri që drejtohet nga ai do të ketë ndikimin pozitiv që policia të jetë profesionale, pasi polica është e shtetit demokratik.

Kryetari- Falënderoi edhe një herë për raportimin dhe bashkëpunimin.

4. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015.

Kryetari- Nëse keni vërejtje ose plotësime ne mund të bëjmë në këtë plan. Ky është drafti i fundit i cili ka dalë nga një punëtori e mbajtur në Pejë dhe për këtë falënderoj anëtarët e Komisionit dhe OSBE-në për mbështetjen.

Në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori:

VENDIM

Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2015

5. Të ndryshme.

Kryetari- Njoftoi se nesër më 3 shkurt, do të jetë një delegacion nga Qendra e Gjenezës për Kontroll demokratik (DCAF), ju ftoj të jeni në këtë takim për në orën 11:30 dhe më pas do të jetë një drekë pune.

Gjithashtu njoftoi se është pranuar Raporti vjetor i Komandantit të FSK-së dhe javën që vjen mund të jetë në raportim, gjithashtu është paraparë një vizitë në kazermën e FSK-së në Istog, në Brigadën e reagimit të shpejtë.

Me këtë pikë e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj